*Duke qene te interesuar per kete procedure, paraqitem oferten tone ne perputhje mete gjitha kushtet dhe kerkesat ligjore, ekonomike dhe teknike te percaktuara ne Dokumentat e Tenderit. Nga KVOjemi njoftuar mes mesazhit elektronik me date 13.03.2020, per klasifikimin e ofertave dhe rider ofertat e skualifikuara eshte oferta e SHPSF "TREZHNJEVA"*
*Arsyet e Skualifikimit: Nuk keni permbushur kerkesen per Qender kontrolli dhe vertetimi nga DVP Diber pasi Aktmiratimi dhe Vertetimi i DVP Diber jane te pavleshme pasi ne QKB ne ekstratin historik regjistruar dt 17/12/2019 Nr.ceshtje CN-431912-12-19 dt 16/12/2019 jane hequr tre adresa midis te cilave "Eshte hequr adresa Diber,Peshkopi,Peshkopi Lagjja SMT Peshkopi" pra vertetimi I DVP Diber dhe aktmiratimi i qendres së kontrollit jane akte absolutisht te pavleshme.*
*Kundershtoj aresyen e skualifikimit pasi nuk eshte e bazur ne ligj dhe prova. Autoriteti Kontraktor ne DST ka kerkuar:*
*3.1.Per kapacitetin ligjor/profesional: Pika 5. Certifikata per punonjes sherbirni ne fushen e veprirntarise se sherbirnit per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objekteve dhe pronave per te pakten 15 punonjes sherbimi te leshuaranga Drejtorite Vendore te Policise,ku ndodhen objektet.*
*- Vertetirn i leshuar nga Drejtorite Vendore te Policise, ku ndodhen objektet, i cili duhet te permbaje te dhena per listen ernerore te punonjesvete sherbirnit te certlfikuar dhe vlefshrnerine e ketvre certifikatave*
*- daten e certifikimit (daten e leshimit), si edhe afatin e vlefshrnerisese kesa] certiflkate.*
*Per plotesimin e ketij kriteri ne kemi paraqitur vertetim nga DVP Diber me nr.32/1 date 05.02.2020 ku plotesohet plotesisht kerkesae Autoritetit Kontraktor mete dhenat e kerkuara.*

*3.1 Per kapacitetin teknik: pika 7.*
*Akti i Miratimit te Qendres se Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit ne Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performaces mbi menyren e ushtrimit te aktivitetit te operatorit ekonomik te leshuar jo me shume se tre muaj nga afati i fundit i pranimit te ofertave. Per kete duhet te paraqese vertetim nga Drejtorite Vendore te Policise, ku ndodhen objektet ku jepet informacioni i mesiperm i kerkuar. Per plotesimin e ketij kriteri ne kemi paraqitur vertetim nga DVP Diber me nr.32/1 date 05.02.2020 ku plotesohet plotesisht kerkesae Autoritetit Kontraktor mete dhenat e kerkuara dhe Akt- Miratimin e QKSH me nr.213/3 date 11.07.2018.*

*Lidhur me pretendimin e Autoritetit Kontraktor se e ben te pavlefshem vertetetimin e DVP qarku Diber per ekzistencen e qendres kontrollit sherbimit pasi eshte leshuar ne menyre fiktive nuk qendron pasi QKSH ekziston ne ate adres dhe eshte ne funksion te plote dhe se adresa eshte per tu identifikuar vendodhja e qendres kontrollit sherbimit.*
*Pika 12. Salle operative ne pronesi ose me qera me vendndodhje ne qytetin e Peshkopise.*
*Per plotesimin e ketij kriteri ne kemi paraqitur kontraten e Qerase ku vertetohet objekti ku eshte ngritur Salla dhe koha e marrjes me qera .*
*Sipas DST kemi paraqitur gjithë dokumentacionin e kerkuar dhe se Autoriteti Kontraktor nuk mund te skualifiokoje asnje operator ekonomik per nje kriter te pa kerkuar ne DST.*
*Ne lidhje me konstatimin tuaj se QKSH dhe Vertetimi i DVP Diber jane Akte absulutisht te pavlefshme pasi eshte hequr adresa ne Diber sqarojme se: Se pari procedura eshte shpallur me 19.11.2019, para se te mbyllet adresa dhe nuk jeni ju Autoriteti qe beni pavlefshmerin e nje Akti te nxjerr nga nje instutucion tjeter pasi Komisioni i Certifikimit te QKSH prane DVP Diber e ka miratuar dhe eshte gjendje e pershtatshme per menaxhimin e sherbimeve ne adresen qe eshte ne vertetim. Ju sqarojme se Heqja e adreses ne Diber eshte bere per mos kreditim te taksave vendore per Bashkin Diber pasi po te lexohet kontrata me kujdes gjitha detyrimet paguhen nga qeradhanesi si drita ,uje dhe tatim ne burim. Detyrimi im deri me 31.12.2019 ndaj bashkis Diber ka qene pagesa e takses se nderteses (ambjentit qe shfrytezoj) te cilat i kam bere pagesat por me qe me vendim qeverie kjo taks eshte futur ne faturen e ujit dhe merret persiper nga pronari i nderteses ku ndodhet QKSH. Adresa e QKSH eshte ajo qe ndodhet ne Vertetimin e DVP Diber. Per Autoritetin Kontraktor eshte e rendesishme qe Opratoret Ekonomik te plotesojne kriteret per kualifikim dhe te zoterojne kapacitetet e nevojshme per realizimin e kontrates. "Te disponosh sallë operative ne Qarkun e Dibres nuk do te thote se duhet te kesh nje ndertese apo ngrehine, por realizimin e nderlidhjes. Persa i perket konceptit mbi sallën operative, komisioni i Prokurimit Publik esnte shprehur me Vendimin Nr. 91/3 prot., date 21.02.2013 se, Salle Operative nenkupton realizimin e nderlidhjes midis njesive te shoqerise qe do te kryejne sherbimin e ruajtjes me roje dhe Sistemit te Pavarur te Radiokomunikimit, te cilat jane të ekzistences dhe funksionimit te kesaj Salle"; Pra, per realizimin e sherbimit te ruajtjes me roje, rendesi kane pajisjet qe do te sherbejne per sistemin e radiokomunikimit dhe jo "salla operative" ne kuptimin e ambientit ku vendosen keto pajisje. Ne DST, nuk eshte kerkuar ne asnje kriter qe Operatori Ekonomik duhet te kete adres dytesore ne QKR per qytetein Diber kjo eshte aresyeja qe skualifikimi eshte bere ne kundershtim me LPP.*
*Si perfundfm kerkojme:*
*Se pari : Marrjen parasysh te ankeses tone.*
*Se dyti : Pezullimin e procedures deri ne shqyrtim te plotë te ankeses tone.*
*SeTreti: Kualifikimin e Firmes "TREZHNJEVA" pasi ka plotesuar gjitha kerkesat per kualifikim sipas kritereve te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne DST [....]*

II.6. Në datën 13.03.2020, operatori ekonomik “SHPSF Snajper Security” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

*Nuk keni plotesuar sipas kerkesave te ligjit deklaraten per plotesimin e kritereve te pergjithshme.*

II.6.1. Operatori ekonomik në datën 19.03.2020 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues kundërshton kualifikimin e operatorët ekonomikë "Eurogjici Security" sh.p.k "Kevenjo"sh.p.k. "Nazeri 2000" sh.p.k.,si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë"Grand Security" sh.p.k. "Internacional Security Albania" sh.p.k. "RES-03" sh.p.k.. Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij argumenton si më poshtë vijon:

*[...] Shpsf "SNAJPER SECURJTY II shpk pasi u njoh elektronikishte me klasifikimin me daten*

*13 / 03 / 2020 ora 14-19 minuta si me poshte vijon:*

| | | | |
|---|---|---|---|
| *1- EUROGJICI-SECURITV* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *JO* |
| *2- KEVENJO* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *JO* |
| *3- NAZERI- 2000* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *JO* |
| *4- GRAND-SECURITY* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |
| *5- INTERNACIONALSECURITY ALBANIA* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |
| *6- RES-03* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |
| *7- SNAJPER SECURtlY* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |
| *8- TREZHNJEVA* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |

*Shikojme se shoqeria jone eshte skualifikuar me te pa drejte nga Komisioni i Vlersimit te Ofertave te Autoriteti Kontraktor, dhe arsyja e skualifikimit eshte: 11 Se nuk keni plotesuar sipas kerkesave te ligjit deklaraten per plotesimin e kritereve te pergjithshme 11 •Kjo nuk eshte e vertete pasi ne i kemi plotesuar te gjitba deklaratat ne DST dhe kerkesat sipas shtojcave te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor: Prandaj sa me siper kerkojme rivlersimin e Ofertave dhe kualifikimin e Shoqerisë "Shpsf Snajper Security" sh.p.k.*

1. *Duhet skualifikuar shoqeria "Eurogjici Security" sh.p.k. pasi vertetimi i Funizimit te Sherbimit Universal nuk eshte brenda afatit te zhvillimit te procedures.*
2. *Duhet te skualifikohet shoqeria "Kevenjo"sh.p.k. pasi kjo shoqeri eshte ne hetim administrative per fshehje te ardhurash dhe se dyti ka marre mase administrative gjatë ushtrimit te kontrollit nga ana e Drejtorise Vendore te Policise Diber.*
3. *Duhet te skualifikohet edhe "Nazeri 2000" sh.p.k. pasi nuk ka plotesuar kerkesat e dhena ne DST nga Autoriteti Kontraktor.*
4. *Nga ana e AK-se tu shtohet arsyes se skualifikimit te shoqerive "Grand Security" sh.p.k. "Internacional Security Albania" sh.p.k. "RES-03" sh.p.k., pasi nuk permbushin kerkesat e dhena nga AK-ja ne DST-te grupit të gatshëm operatorve sipas kerkesave te ligjit.*

*Perfundimisht nga Argumentimi i bere sa me siper kerkojme nga Autoritetit Kontraktore te behet kualifikimi i shoqerise sone pasi arsyet e skualifikimit nuk qendrojne, pra skualifikimi eshte bërë ne menyre te njeanshme dhe te padrejte, si dhe nga ana e AK-se te skualifikohen shoqerite "Eurogjici Security" sh.p.k "Kevenjo"sh.p.k. "Nazeri 2000" sh.p.k. "Grand Security"*

*sh.p.k. "Internacional Security Albania" sh.p.k. "RES-03" sh.p.k. pasi nuk plotesojne kerkesat ne DST.*
*Shpresojme se kerkesa jone do te merret ne konsiderate, pasi do te jemi te detyruar ne ndjekjen e te gjitha shkalleve te ankimimit*
*Ankesen jua kemi nisur edhe ne menyre elektronike me daten 19.03.2020*
*Po iua dergojme edhe me poste dhe ko jene ju kemi derguar elektronikisht,*
*Si dhe njoftimin Nr.2245 prot date 12/03/2020 Te Drejtorit te Pergjithshem[...]*

II.6.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 25.03.2020, me anë të shkresës nr.312/2 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atëme argumentat si më poshtë vijon:
*[...]Ne ankesen tuaj nr. 12 prot., date 19.03.2020 drejtuar Autoritetit Kontraktor-Drejtorise Spitalit Rajonal Diber (ardhur ne autoritetin kontraktor-Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber me date 24.03.2020), per proceduren e prokurimit: "Procedure e hapur" me nr. REF-43724-11-18-2019, me objekt: "Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private te godinave dhe ambienteve rrethuese te Spitalit Rajonal Diber", Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj, tre vend roje me tre turne (Tl+T2+T3), me fond limit: 9.487.854 (Nente milione e katerqind e tetedhjete e shtate e teteqind e pesedhjete e kater)leke pa tvsh , i zhvilluar me date: 02.03.2020, Ora: 10:00.*
*Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber me date 19.03.2020 "Per pezullimin tenderi dhe ngritjen e komisionit per shqyrtimin e ankeses/ankesave per te gjitha ankesat qe do te mberrijne ne lidhje me kete procedure", ka vendosur pezullimin e kesaj procedure prokurimi deri ne shqyrtimin e plote te ankeses si dhe me ane te ketij urdheri ka ngritur dhe komisionin per shqyrtimin e ankeses. Komisionit i shqyrtimit te ankeses (KSHA) pasi u njoh me pretendimet e ngritura ne ankesen Tuaj, ku keni marrë pjese ne kete procedure prokurimi dhe jeni skualifikuar nga ana e komisionit te vleresimit te ofertave. Ne pergjigje te ankeses tuaj ju sqarojme: Ne LPP 9643 "KREU VII" PROCEDURAT E RISHIKIMIT ADMINISTRATIV,Neni 63,Te drejtat e personit te interesuar, pika 2. Ankesa kunder vendimeve te autoritetit kontraktor i paraqitet. se pari. me shkrim. autoritetit kontraktor ne fjalë brenda 7 diteve nga dita kur ankimuesi eshte vene ne diieni ose duhet te ishte vene ne diieni per shkelien e pretenduar. sipas ketii ligji.*
*Ankesa juaj ka mberritur prane AK me date 24/03/2020 pra 4 dite me vone se afati 7 ditor i parashikuar ne ligj. Per sa me siper permendem, Autoriteti Kontraktor- Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber nuk i mer parasysh pretendimet e paraqitura ne ankesen Tuaj[...]*

II.6.3. Në datën 06.04.2020 operatori ekonomik "SHPSF Snajper Security" sh.p.k.ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjta pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.
Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij argumenton si më poshtë vijon:
*[....]" Shpsf II SNAJPER SECURITY" sh.p.k. pasi u njoh me pergjigjen e ankeses tone te kthyer nga Autoriteti Kontraktor me daten 31 /03 /2020 ora 15, 45 minuta, qe ankesen tone nuk e kishte*

*marrë parasysh me pretendimin qe ankesa eshte derguar jashte afateve ligjore me 4 (kater ) dite me vonese. Ne ju sqarojme si Autoriteti me i larte, se ankesen ja kemi derguar ne menyre elektronike me daten 19 / 03 / 2020, dhe me daten 20 /03 / 2020 ja kemi postuar me poste duke e konfirmuar edhe me faturen postare qe po ua dergojme bashke me ankesen juve si KPP. Nga klasifikimi i meposhtem:*

| | | | |
|---|---|---|---|
| *1-EUROGJICI-SECURITV* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *JO* |
| *2- KEVENJO* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *JO* |
| *3- NAZERI- 2000* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *JO* |
| *4- GRAND-SECURITY* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |
| *5- INTERNACIONALSECURITY ALBANIA* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |
| *6- RES-03* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |
| *7- SNAJPER SECURtlY* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |
| *8- TREZHNJEVA* | *ME OFERTE* | *8654.74 Leke* | *PO* |

*Shikojme se shoqeria jone eshte skualifikuar me te pa drejte nga Komisioni i Vlersimit te Ofertave, dhe arsyja e skualifikimit eshte: 11 Se nuk keni plotesuar sipas kerkesave te ligjit në deklaraten per plotesimin e kritereve te pergjithshme 11•*

*Së`pari kjo nuk eshte e vertete pasi ne i kemi plotesuar te gjitba deklaratat ne DST dhe kerkesat sipas shtojcave te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor: Prandaj sa me siper kerkojme rivlersimin e Ofertave dhe kualifikimin e Shoqerisë “Shpsf Snajper Security” sh.p.k.së dyti i kemi kërkuar skualifikimin e shoqerive:*

*1.Duhet skualifikuar shoqeria “Eurogjici Security” sh.p.k. pasi vertetimi i Funizimit te Sherbimit Universal nuk eshte brenda afatit te zhvillimit te procedures.*

*2.Duhet te skualifikohet shoqeria “Kevenjo”sh.p.k. pasi kjo shoqeri eshte nehetim administrative per fshehje te ardhurash dhe se dyti ka marre mase administrative gjatë ushtrimit te kontrollit nga ana e Drejtorise Vendore te Policise Diber.*

*3.Duhet te skualifikohet edhe “Nazeri 2000” sh.p.k. pasi nuk ka plotesuar kerkesat e dhena ne DST nga Autoriteti Kontraktor.*

*Se treti i kemi kerkuar AK-se Lenien ne fuqi skualifikimin e shoqerive te meposhtme "Grand Security" sh.p.k. “Internacional Security Albania” sh.p.k. “RES-03" sh.p.k., pasi nuk permbushin kerkesat e dhena nga AK-ja ne DST-te grupit të gatshëm operatorve sipas kerkesave te ligjit. Perfundimisht nga argumentimi qe i kemi bere sa me siper Autoritetit Kontraktor kerkojme:*

*Nga ana e Komisionit te Prokurimit Puhlike kerkojme; te pezulloje Procedurën e zhvilluar me date 02/03/2020 nga ana e Drejtoria Spitalit Rajonal Diber, Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, dhe marrjen parasysh te ankeses se Shoqerise " Snajper Security” sh.p.k. pasi nga ana e Autoritetit Kontraktor kjo procedure eshte shtyre disa here pa asnje lloje arsye vetem e vetem qe te favorizojnë firmen qe aktualish te bene sherbimin edhe ne kete periudhe qe vazhdon procedura pasi kesaj shoqerie i ka mbaruar kontrata qe ne muajn dhjetor te vitit 2019.*

*Vlerësimi i Operatoreve Ekonomike nga ana KVO-se eshte bere ne kundeshtim nga Autoriteti Kontraktor pasi me daten 12.03.2020 ka dalur njoftimi Nr. 2245 prot i Drejtorit te Pergjithshem Reida KASHTA, kurse Autriteti Kontraktor bënë vlersimin e Operatorve*

*Ekonomike ne kundeshtim me kete njoftim me daten 13.03.2020 ora 14 - 19 minuta nje dite pas njoftimit, ku thuhet qarte: per procedurat e prokurimit qe jane ne proces, pra ato qe jane ne proces vlersimi, te shtyhen si afati i dorzimit te ofertave ashtu dhe afati i vlersimit te tyre me 15*
*dite, duke nisur nga dita e sotme, date 12.03.2020. Ankesen AK-se jua kemi nisur edhe ne ne menyre elektronike me daten 19/03/2020. Por ua kemi derguar edhe me poste Si dhe Njoftimin Nr.2245 prot date 12/03/2020 Te Drejtorit te Pergjithshem, Reida Kashta.*
*I gjithë dekomentacioni elektronikisht, Sa me siper kerkojme:*
*Se pari : marrjen parasysh te ankeses tone.*
*Se dyti: Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses tone.*
*Se treti: Skualifikimin e Ofertave te Shoqerive "Eurogjici Security" sh.p.k "Kevenjo"sh.p.k. "Nazeri 2000" sh.p.k. sipas argumentimit te mesipem.*
*Lenien ne fuqi skualifikimin e shoqerive te meposhtme dhe tu shtohet .arsyes .s.e skualifikimit te shoqerive "Grand Security" sh.p.k. "Internacional Security Albania" sh.p.k. "RES-03" sh.p.k., pasi nuk permbushin kerkesat e dhena nga AK-ja ne DST-te; qe nuk permbushin kerkesat e DSt-së te vendosura nga AK-ja.*
*Se katerti: Kualifikimin e shoqerise " Snajper Security" shpk si oferte qe ploteson te gjitha kushtet dhe kriteret te vendosura nga Autoriteti Kontraktor ne DST-ne.[......]*

II.7. Në datën 14.04.2020, nëpërmjet shkresës me nr.3281 prot., datë 09.04.2020, me objekt: *"Dërgojmë informacionin mbi vendimin tuaj Nr. 329/1 Protokolli datë 02.04.2020",* është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

## III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Grand Security" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se "*Nuk ploteson kriterin e DST kreu 3.1 Per kapacitetin ligjor/professional,pika 5 per numrin e rojeve te certefikuara ku nga 15 certifikata punonjesish keni paraqitur vetem 11 certifikata; ,Certifikata e Agron Berhamit eshte ne listen emrore te DVP per operatorin Nazeri 2000,certifikata e Halit Xharit eshte ne listen e DVP per operatorin Trezhnjeva.[...]".*" Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 8, "*Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë",* pka 5. e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

*5. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 15 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtorite Vendore te Policise, ku ndodhen objektet.*

*- Vërtetim i lëshuar nga Drejtorite Vendore te Policise, ku ndodhen objektet, i cili duhet të përmbajë të dhena për listën emërore të punonjësve të shërbimit të çertifikuar dhe vlefshmërinë e këtyre çertifikatave – datën e çertifikimit (datën e leshimit), si edhe afatin e vlefshmërisë së kësaj çertifikate.*

III.1.2. Në Shtojcën 8, "*Kriteret e veçanta të kualifikimit",* pika 9 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

*Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 15 punonjës të siguruar në muaj, 15 punonjes sherbimi roje pa perfshire drejtuesin teknik dhe administratorin.*

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k., në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. *Shkresën nr. 32/2 prot., datë 14.02.2020 për operatorin ekonomik "Grand Security" sh.p.k lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, bashkëlidhur lista emërore*
2. *15 certifikata të punonjësve leshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër (certifikata të cilat korrespodojnë me emrat e shënuar në listën emërore të punonjësve të shërbimit bashkëlidhur shkresës nr. 32/2 prot., datë 14.02.2020)*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese;".*
Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit".*

III.1.5. Në nenin 5 të Ligjit Nr. 75/2014 "*Për shërbimin privat të sigurisë fizike*", parashikohet shprehimisht se*:*
*1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*
*2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.*

*3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.*
*4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësin e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.*
*5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit.*

III.1.6. Neni 7 "*Kategoritë e licencës*" i ligjit Nr. 75/2014 "*Për shërbimin privat të sigurisë fizike*", parashikon shprehimisht se:
*"Licencat, sipas këtij ligji, ndahen në dy nënkategori:*
*a) nënkategoria I.3.A, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit;*
*b) nënkategoria I.3.B, "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit", i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit".*
III.1.7. Ndërsa Neni 9 "*Llojet e certifikatave*" i ligjit Nr. 75/2014 "*Për shërbimin privat të sigurisë fizike*", parashikon shprehimisht se:
*"1. Certifikatat për titullarin e SHPSF-së, për drejtuesin teknik dhe për punonjësin e shërbimit ndahen në lloje, sipas nënkategorive të licencës.*
*2. Çdo i interesuar për punonjës shërbimi të SHPSF-së ka të drejtë të pajiset me certifikatë, sipas nënkategorive të licencave".*

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46, pika 1, gërma *"b",* të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon se: *"[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [....]".*

III.1.9. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, kritereve të përcaktuar në dokumentat e tenderit si më sipër cituar, duke iu referuar verifikimit të kryer në SPE, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k., me anë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE arrin të provojë se përmbush me sukses kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor për disponimin nga ana e tij e 15 punonjësve të shërbimit për Qarkun e Dibër pasi shkresa e lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër nr. 32/2prot., datë 14.02.2020 për operatorin ekonomik "Grand Security" sh.p.k vërteton se "numri i punonjësve të shërbimit të certifikuar dhe të deklaruar është 16" ndërsa nga ana e këtij subjekti janë paraqitur 15 certifikata për punonjës shërbimi, të vlefshme brenda afatit 4-vjecar

nga data e lëshimit të tyre, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, duke e plotësuar numrin e punonjësve të shërbimit të certifikuar referuar kërkesësë së autoritetit kontraktor për punonjës të certifikuar. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k. ka vërtetuar se zotëron kapacitetin teknik në lidhje me numrin e punonjësve të shërbimit dhe certifikatat profesionale sipas përcaktimit të autoritetit kontraktor.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Grand Security" shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Grand Security" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se *"Deklarimin e ofertes nuk e keni plotësuar sipas shtojces 1 dhe udhezimit per plotesimin e saj.[…]"* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, (modifikuar nga autoriteti kontraktor), në shtojcën nr. 5 datë 24.02.2020 Shtojca 1 "Formulari i ofertës", autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

<u>*Ishte*</u>

*Shtojca 1*

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]*

*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE*

*Emri i Ofertuesit*______________________

*Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

*Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]*

*Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]*

*Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

* * *

*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:*

*5. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;*

*6. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH*

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|
| *Nr* | *Përshkrimi i Shërbimeve* | *Sasia* | *Çmimi Njësi* | *Çmimi Total* | *Afati* |
| | *"Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të godinave dhe ambienteve rrethuese të Spitalit Rajonal Diber", Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, tre vend roje me tre turne (T1+T2+T3).* | | | | *duke filluar nga nga data e lidhjes se kontrates me përfundim në momentin qe kompania e krijuar enkas me VKM nr.177 date 04/04/2019 do te paraqitet per zbatimin e kesaj VKM do te shkeputen te gjitha maredheniet kontraktuale* |
| *Çmimi Neto )* | | | | | |
| *TVSH (%)* | | | | | |
| *Çmimi Total* | | | | | |

*Nënshkrimi i ofertuesit _______________*

*Vula _______________*

*Shënim:*

*Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____( e kerkuar ne dokumentat e tenderit)*

<u>*Behet*</u>

*Shtojca 1*

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]*

*FORMULARI I OFERTËS*

*Emri i Ofertuesit*_____________________

*Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

*Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]*

*Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]*

*Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

* * *

*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:*

7. *Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;*
8. *Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH*

| *1* | *2* | *3* | | *4* | *5* |
|---|---|---|---|---|---|
| *Nr* | *Përshkrimi i Shërbimeve* | *Njesia* | *Sasia* | *Çmimi Njësi /ditë* | *Afati i perllogaritur në ditë* |
| *1.* | *"Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të godinave dhe ambienteve rrethuese të Spitalit Rajonal Diber", per 1 vend roje me 3 turne* | *ditë* | *1* | | *duke filluar nga nga data e lidhjes se kontrates me përfundim në momentin qe kompania e krijuar enkas me VKM nr.177 date* |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | *04/04/2019 do te paraqitet per zbatimin e kesaj VKM do te shkeputen te gjitha maredheniet kontraktuale* |
| | *Çmimi Neto* | | | | |
| | *TVSH (%)* | | | | |
| | *Çmimi Total* | | | | |

*Nënshkrimi i ofertuesit* _______________

*Vula* _______________

*Sqarime:*

**5.** *Ne çmim jane te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.*

**6.** *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.*

*Analize e kostos*

| *Nr.* | *Emërtimi* | *Vlera (Lek)*<br>*1 roje /dite* | *Vlera (Lek)*<br>*1 vendroje me tre turne /dite* |
|---|---|---|---|
| 1 | *Shpenzime për pagë bazë* | | |
| 2 | *Shtesë mbi pagë për turnin II* | | |
| 3 | *Shtesë mbi pagë për turnin III* | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | *Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%* | | |
| | *Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite* | | |
| | *Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite* | | |

- *Operatoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 3.5.2017," Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*
- *Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*
  *Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar ne dokumentat e tenderit )*

*Theksojme se Sherbimi kerkohet per 3 (tre) vend roje ne muaj pra per 3 x4.98 = 14,94 roje ne muaj dhe se oferta e Operatoreve Ekonomike pjesemarres ne procedure duhet te jete ne baze ditore per 1 (nje) vend roje .*

*IV.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:*

*Ishte Date 15.12/2019 ora 12:00*

*Behet Data:02/03/2020 Ora: 12:$^{00}$*

*Vendi: ëëë.app.gov.al DRS Diber, Peshkopi.*

*Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al*

*IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:*

*Ishte Date 15/12/2019 ora 12:00*

*Behet Data: 02/03/2020 Ora: 12:$^{00}$*

*Vendi: ëëë.app.gov.al DRS Diber, Peshkopi.*

*Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, qe paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.*

*Kjo shtojce do ti bashkengjitet dokumenteve te tenderit dhe do te vihet ne dispozicion edhe ne rruge elektronike.*

*Njesia e prokurimit:*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurmit Elektronik (S.P.E) nga operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

*1. Formularin e ofertës ekonomike, sipas Shtojcës 1 (i paraqitur në vlerë totale ditore).*

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.".*
Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

III.2.4. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme

III.2.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k. ka dorëzuar formularin e ofertës të plotësuar në përputhje me të gjitha të dhënat e përcaktuara në shtojcën 1 të sipërcituar. Rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur formularin e ofertës të ofertuar në total (kosto ditore) si dhe analizën e kostos ditore për vendrojen që do të ruhet, në përputhje me përcaktimet në DST, për të gjitha zërat e shpenzimeve pagë shtesat për turnin e dytë

dhe të tretë si dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore në masën 16,7%. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik ankimues ka bërë plotësimin e shtojcës së formularit të ofertës sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi. Në rastin konkret, Komisioni kontaton se operatori ekonomik ankimues ka vendosur çmimin total të ofertës ditore të përcaktuar me shifra dhe me fjalë, për më tepër në rastin e procedurave të prokurimit të shërbimit privat të sigurisë fizik , të cilat janë specifike në lidhje me procedurat e tjera, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë paraqitjen e preventivit dhe analizën e kostos, e cila është paraqitur nga ankimuesi ku lehtësisht është e verifikueshme që përllogaritjet janë kryer sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi. Gjithashtu Komisioni konstaton se klasifikimi dhe kuotimi i ofertuesve në sistemin e prokurimeve elektronike bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë në total dhe akoma më tej autoriteti kontraktor në përcaktimin e vlerës së kontratës bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Grand Security” sh.p.k nuk përmban pasaktësi të tilla të cilat e bëjnë një ofertë të pavlefshmë në kuptim të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 si më sipërcituar. Komisioni gjykon se në lidhje me këtë ofertë autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar në përputhje me LPP-në dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Grand Security” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se *“Deklarata per plotesimin e kritereve te pergjithshme nuk eshte plotesuar sipas ligjit.[…]”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 “Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme”, përcaktohet:

*Shtojca 7*

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

*DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME*

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ___________________me fond limit __________.*

*Unë i nënshkruari ________________ me cilesinë __________ të operatorit ekonomik ________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- *Operatori ekonomik ____________________ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".*

- *Operatori ekonomik __________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.*

- *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

  ____________________

  ____________________

  ____________________ *etj.*

  *nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP*[1]*.*

- *Operatori ekonomik __________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

- *Operatori ekonomik __________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*

- *Operatori ekonomik __________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

III.3.2. Në shtojcën 8"*Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit*" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

[1] Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

*a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".*
*b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*
*c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*
*ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
*d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.*

*Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.*

*Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.*

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit*."

III.3.4. Në nenin 45, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" parashikohet shprehimisht se: "*1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme*:

*a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;*
*b) korrupsion;*
*c) mashtrim;*
*ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;*
*d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;*
*dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;*
*e) falsifikim;*
*ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.*
***Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.***
*2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë , në rastet kur:*
*a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit ;*
*b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;*
*c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
*ç) ;*
*d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;*
*dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;*
*e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre , ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.*
*ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.*
*3. Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*
*a)Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefshëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronja "a", "b" dhe "c" .*
*b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat "d" e "dh".*

III.3.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues "Grand Security" sh.p.k. në përmbushje të shtojcës sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Shtojca 8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme" me përmbajtje si vijon: Unë i nënshkruari Liljana Shehu me cilësinë e Administratorit të Përgjithshëm të operatorit Grand Security deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se operatori ekonomik Grand Security është i regjistruar në QKB dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
Gjithashtu është deklaruar se "personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:
1. Znj. Liljana Shehu
2. Arblin Karaj
Hasan Kërtoçi e shoqërisë nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP."
Ekstraktin e Rregjistrit Tregtar datë 26.02.2020 dhe Ekstraktin Historik datë 26.02.2020.

III.3.6. Bazuar në pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues , si dhe referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të kualifikimit kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të pikës 3 të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Në rastin konkret, nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k., në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar deklaratën mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme. KPP konkludon se nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k. e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Trezhnjeva" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se *"Nuk keni permbushur kerkesen per Qender kontrolli dhe vertetimi nga DVP Diber pasi Aktmiratimi dhe Vertetimi i DVP Diber jane te pavlefshme pasi ne QKB ne ekstratin historik regjistruar dt 17/12/2019 Nr.ceshtje CN-431912-12-19 dt 16/12/2019 jane hequr*

*tre adresa midis te cilave "Eshte hequr adresa Diber,Peshkopi,Peshkopi Lagjja SMT Peshkopi" pra vertetimi i DVP Diber dhe aktmiratimi i qendres së kontrollit jane akte absolutisht te pavleshme. [...]"*
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 8 dhe 7 janë përcaktuar kriteret si më poshtë vijon:

*8. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performaces mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik te leshuar jo me shume se tre muaj nga afati i fundit i pranimit te ofertave.*

*Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtorite Vendore te Policise, ku ndodhen objektet ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.*

*7.Operatori Ekonomik duhet te paraqes Vertetim Performance nga Drejtorite Vendore te Policise ku ndodhen objektet ku do te kryhet sherbimi, leshuar brenda 3 (tre) muajve, nga data e hapjes se ofertave, ku te jepet informacioni si me poshte:*

*a.Per numrin e armeve te krahut dhe armeve te brezit ne pronesi.*

*b.Te kete grupe te gatshme punonjesish per verifikim te sinjaleve te alarmit*

*c.Qe ka radiokomunikimi, hekura lidhes, shkopinj gome.*

*d.Nuk ka mase administrative per Operatorin Ekonomik (Subjektin) gjate periudhes 1 Janar 2019 e ne vazhdim.*

III.4.2. Nga verifikimi në S.P.E (sistemin e prokurimeve elektronike) të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit Shtojca 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", nga operatori ekonomik ankimues është paraqitur:

"Performancë e subjektit "Treznjeva" shpk lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër me nr.prot 32/1, datë 05.02.2020 , sipas së cilës shoqëria disponon qendër kontrolli në Peshkopi Bashkia Dibër".

*Akt Miratimi për Qendrën e Kontrollit të SHPSF nr.213/3 protokolli, datë 11.07.2018 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër me anë të së cilës vërtetohet se: Subjekti "Trezhnjeva" Nr. NIPT: K19303605O. "Bazuar në kërkesën e nenit 22 të ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" dhe Kapitulli V, gërma "b" dhe "c" të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.130 datë 04.03.2018 "Për funksionmin e shërbimit privat të sigurisë fizike" miratoj "Qendra e Kontrollit të Subjektit "SHPSF "Trezhnjeva" nënkategoria I.3.A gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.".*

III.4.3. Në nenin 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar prashikohet se *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”*
Në nenin 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.4.4. Në nenin 22 të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikohet se: *“1. Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë. 2. Qendra e kontrollit të shërbimit kryen detyrat e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike. 3. Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë”*

III.4.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët 26 ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur arrin të provojë se disponon kapacitet teknik lidhur me qedrën e kontrollit në përputhje me kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi dhe me legjislacionin në fuqi.
Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “SHPSF Snajper Security” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se *“Nuk keni plotesuar sipas kerkesave te ligjit deklaraten per plotesimin e kritereve te pergjithshme. [...]”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 “Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme”, përcaktohet:

*Shtojca 7*

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

*DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME*

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ___________________me fond limit __________.*

*Unë i nënshkruari __________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik ___________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- *Operatori ekonomik ______________________ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".*

- *Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.*

- *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

  _____________________

  _____________________

  _____________________*etj.*

  *nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP*[2]*.*

- *Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

- *Operatori ekonomik ____________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*

- *Operatori ekonomik ____________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

[2] Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

III.5.2. Në shtojcën 8"*Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit*" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

*a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".*
*b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*
*c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*
*ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
*d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.*

*Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.*

*Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.*

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit*."

III.5.4. Në nenin 45, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" parashikohet shprehimisht se: "*1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme*:
*a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;*
*b) korrupsion;*
*c) mashtrim;*
*ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;*
*d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;*
*dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;*
*e) falsifikim;*
*ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.*
***Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.***
*2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë , në rastet kur:*
*a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit ;*
*b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;*
*c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
*ç) ;*
*d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;*
*dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;*
*e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre , ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.*
*ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.*
*3. Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

*a)Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefshëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronja "a", "b" dhe "c" .*
*b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat "d" e "dh".*

III.5.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. në përmbushje të shtojcës sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:
Shtojca 8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme" me përmbajtje si vijon: Unë i nënshkruari Xhemal Osman Bajraktari me cilësinë e Administratorit të Përgjithshëm të operatorit "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se operatori ekonomik "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. është i regjistruar në QKB dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Gjithashtu është deklaruar se "personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

1. Xhemal Osman Bajraktari Administrator Kategoria 1.3.A
2. Fehmi Ismail Shahini Drejtues Teknik Kategoria 1.3.A.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP."
Ekstraktin e Rregjistrit Tregtar datë 16.01.2020 dhe Ekstraktin Historik datë 16.01.2020.

III.5.6. Bazuar në pretendimin e ngritur nga operatori ekonomik ankimues , si dhe referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të kualifikimit kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të pikës 3 të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Në rastin konkret, nga verifikimet e

kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik "SHPSF Snajper Security" sh.p.k., në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar deklaratën mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme. KPP konkludon se nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, operatori ekonomik "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomikë ankimues "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "Kevenjo" shpk, me argumentin se *"dhe se dyti ka marre mase administrative gjatë ushtrimit te kontrollit nga ana e Drejtorise Vendore te Policise Diber."* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.6.1. Në Shtojcën 8 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" pika 2.3 "Kapaciteti teknik" të dokumentave të proçedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteret si më poshtë:

*Operatori Ekonomik duhet te paraqes Vertetim Performance nga Drejtorite Vendore te Policise ku ndodhen objektet ku do te kryhet sherbimi, leshuar brenda 3 (tre) muajve, nga data e hapjes se ofertave, ku te jepet informacioni si me poshte:*

a. *Per numrin e armeve te krahut dhe armeve te brezit ne pronesi.*
b. *Te kete grupe te gatshme punonjesish per verifikim te sinjaleve te alarmit*
c. *Qe ka radiokomunikimi, hekura lidhes, shkopinj gome.*
d. *Nuk ka mase administrative per Operatorin Ekonomik (Subjektin) gjate periudhes 1 Janar 2019 e ne vazhdim.*

III.6.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "Kevenjo" sh.p.k., ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:
- Vërtetim me Nr 18 Prot datë 21.01.2020, për subjektin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike "Kevenjo", nga ku rezulton se kjo shoqëri nuk ka ngjarje të ndodhura dhe masë administrative.

III.6.3. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në proçedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin*

*e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, përcakohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.6.4 Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton se operatori ekonomik "Kevenjo" sh.p.k., në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifkimit ka paraqitur dokumentacionin e duhur që vërteton pikën 7 të kapacitetit teknik, vërtetimi i lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku evidentohet se operatori ekonomik i mësipërcituar nuk kanë ngjarje të ndodhura dhe masë administrative nga strukturat e policisë së shtetit.

III.6.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në proçedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më sipër pretendimi i ankimuesit operatorit ekonomik "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomikë ankimues "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "Kevenjo" sh.p.k., me argumentin se "*pasi kjo shoqeri eshte ne hetim administrative per fshehje te ardhurash"* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.7.1. Në nenin 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar parashikohet se *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese"*

Në nenin 53 pika 4 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar parashikohet se: *"Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj"*

Në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar parashikohet se: *"Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit."*

III.7.2. Duke mbajtur në vëmendje nenin 45 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, parashikohet se *"Autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit çdo kandidat ose ofertues, kur ka të dhëna se janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për ndonjë nga veprat e mëposhtme:*
*a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;*
*b) korrupsion;*
*c) mashtrim;*
*ç) pastrim parash.*
*d) fallsifikim*
*Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentet e përmendura në pikën 3 të këtij neni dhe, kur ka dyshime, mund t'u drejtohet organeve kompetente për të marrë ndonjë informacion të nevojshëm për integritetin dhe gjendjen personale të ofertuesve në fjalë. Kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, atëherë autoriteti kontraktor mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente.*
*2. Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:*
*a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit*
*b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;*
*c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
*ç)*
*d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;*
*dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;*
*e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë seksion, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.*
*ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.*
*3. Autoriteti kontraktor pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente:*

*a) vërtetim nga dosja gjyqësore, ose në rast se nuk sigurohet kjo, një dokument të njëvlershëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent, gjyqësor apo administrativ, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikat 1 e 2, shkronjat "a", "b" e "c";*
*b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat "d" e "dh".*

III.7.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk ndodhemi në kushtet e parashikuar në nenin 45 të LPP, pasi vetë legjevenesi ka përcaktuar rastet e vecanta kur autoriteti kontraktor ka të drejtë të përjashtojë nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit publik një operator të caktuar ekonomik. Pra *lex specialis* parashikon në mënyrë eksplicide rastet në të cilat autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit çdo kandidat ose ofertues i cili ndodhet në një nga kushtet e parashikuara shprehimisht në nëninin 45 të LPP sa pësipër cituar.
Sa më sipër, për sa kohë që *lex specialis* ka parashikuar në mënyrë shteruese rastet e përjashtimit të operatorëve ekonomikë dhe se rasti i mësipërm nuk parashikohet në nenin 45 të LPP, KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me ofertën e operatorit ekonomik "Kevenjo" sh.p.k nuk është i drejtë.Operatori ekonomik ankimues nuk provon se operatori ekonomik "Kevenjo" sh.p.k ndodhet në njërin prej rasteve të parashikuara në nenin 45 të LPP-së. Për më tepër KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ankesa. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrative, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomikë ankimues "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "Nazeri 2000" sh.p.k., me argumentin se *"3.Duhet te skualifikohet edhe "Nazeri 2000" sh.p.k. pasi nuk ka plotesuar kerkesat e dhena ne DST nga Autoriteti Kontraktor."* si dhe lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "Eurogjici Security" sh.p.k., me argumentin se *"pasi vertetimi i Funizimit te Sherbimit Universal nuk eshte brenda afatit te zhvillimit te procedures."* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.8.1. Në ankesën drejtuar pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për operatorët

ekonomikë "Nazeri 2000" sh.p.k. dhe "Eurogjici Security" sh.p.k. pjesmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.8.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik",

*1. Komisioni zhvillon mbledhjen e tij të parë brenda 5 ditëve nga regjistrimi i ankesës me qëllim shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:*

*a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;*

*b) legjitimimin e ankuesit;*

*c) respektimin e afateve ligjore për ankimin;*

*d) elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 20 të kësaj rregulloreje.*

*2. Relatori verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës dhe nëse autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit. Ai i relaton Komisionit rezultatet e verifikimit.[...]sipas përcaktimeve të nenit 26*

*[...] 3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:*

*a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen ngaKomisioni;*

*b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit,*

*nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;*

*c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. sipas përcaktimeve të nenit 20*

*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe "elementet e domosdoshëm të ankesës" sipas përcaktimeve të nenit 17, "Forma dhe përmbajtja e ankesës",* pika 3: *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;"*

III.8.3. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tyre, ankimuesi duhet të kishin shoqëruar ankesën e tyre me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ankesa. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrative, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe

kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.8.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.8.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/pretendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.8.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qendrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qendron mbi pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.8.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.8.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cila thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave ( pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Për rrjedhojë pretendimet e ankimuesit “SHPSF Snajper Security” sh.p.k. për operatorin ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. dhe operatorin ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. nuk merren shqyrtim.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. për operatorët ekonomikë "Internacional Security Albania" sh.p.k. dhe "Res 03" sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërieve është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 13.03.2020, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të jenë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. për operatorët ekonomikë "Internacional Security Albania" sh.p.k. dhe "Res 03" sh.p.k. nuk do të merret në shqyrtim.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomikë ankimues "SHPSF Snajper Security" sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "Grand Security" sh.p.k., me argumentin se *"pasi nuk permbushin kerkesat e dhena nga AK-ja ne DST-te grupit të gatshëm operatorve sipas kerkesave te ligjit."*. Në lidhje me këtë pretendim KPP do ta marrë në shqyrtim, pasi ndodhemi në kushtet kur operatori ekonomik "Grand Security" ka paraqit ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.10.1. Në shtojcën 8, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", pika 2.1 e "Kapacitetit teknik", nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri:

*8. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performaces mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik te leshuar jo me shume se tre muaj nga afati i fundit i pranimit te ofertave.*

*Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtorite Vendore te Policise, ku ndodhen objektet ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.*

*7.Operatori Ekonomik duhet te paraqes Vertetim Performance nga Drejtorite Vendore te Policise ku ndodhen objektet ku do te kryhet sherbimi, leshuar brenda 3 (tre) muajve, nga data e hapjes se ofertave, ku te jepet informacioni si me poshte:*

*a.Per numrin e armeve te krahut dhe armeve te brezit ne pronesi.*

<u>*b.Te kete grupe te gatshme punonjesish per verifikim te sinjaleve te alarmit*</u>

*c.Qe ka radiokomunikimi, hekura lidhes, shkopinj gome.*

*d.Nuk ka mase administrative per Operatorin Ekonomik (Subjektin) gjate periudhes 1 Janar 2019 e ne vazhdim.*

III.10.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Grand Security" sh.p.k., rezulton se në përmbushje të kriterit të mësipërm, nga ky i fundit është paraqitur dokumentacioni si më poshtë vijon:

3. *Vërtetim "Performanca e Subjektit SH.P.S.F. Grand Security" sh.p.k. nr. 32/2 prot., datë 14.02.2020 për operatorin ekonomik "Grand Security" sh.p.k lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër [...]*

III.10.3. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" dhe gërma "b" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: *"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcakohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ."*

III.10.4. Në nenin 28 pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: *"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.10.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën

përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.10.6. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit

III.10.7. Në nenin 19 "Mbikëqyrja e Veprimtarisë së SHPSF-ve" të Ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin privat të sigurisë fizike", përcaktohet shprehimisht: "Mbikëqyrja e veprimtarisë së SHPSF-ve i nënshtrohet inspektimit të rregullt nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, gjatë të cilit zbatohet legjislacioni në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

III.10.8. Në nenin 20 "Kompetencat Mbikëqyrëse", të Ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin privat të sigurisë fizike", përcaktohet shprehimisht: *1. Strukturat e Policisë së Shtetit kanë këto kompetenca për mbikëqyrjen e veprimtarisë së SHPSF-së: a) kryejnë monitorimin, nëpërmjet dokumentacionit, për aktivitetin e shoqërive të sigurisë fizike; b) kryejnë inspektime për veprimtarinë e shoqërive të sigurisë fizike; c) kryejnë inspektime për mënyrën e kryerjes së detyrës nga punonjësit e këtij shërbimi; ç) kryejnë inspektime për kriteret e mbajtjes dhe përdorimit të armëve, sipas legjislacionit në fuqi; d) kryejnë inspektime për mbajtjen e uniformës, mjeteve lëvizëse, si dhe mjeteve të tjera në përdorim, sipas përcaktimeve në këtë ligj; dh) bëjnë identifikimin e shkeljeve të rregullave të shërbimit, mbajnë procesverbal konstatimi, ndjekin procedurat për marrjen e masave administrative, vendosin gjoba në vend.*

III.10.9. Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*

III.10.10. Referuar sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k. me anë të dokumentacionit të paraqitur vërtetimin e performancës të paraqitur me nr nr. 32/2 prot., datë 14.02.2020 lëshuar nga Drejtoria Vendore Policisë Dibër  nuk dëshmonë se në vërtetimin e performancës të paraqitur të disponojnë grup të gatshëm. Pasi nga verifikimi i vërtetimit të performancës në përmbajtjen e informacionit nuk është e shprehur se ndër të tjera ky operator disponon grup të gatshëm, KPP gjykon se, operatori ekonomikë "Grand Security" sh.p.k. me dokumentacionin e paraqitur nuk e plotësonë kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi në vërtetimet e performancës të depozituar nuk vërtetohet diponueshmëria e grupit të gatshëm. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Sa më sipër, operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur nuk ka arritur të vërtetojë përmbushjen e kapacitetit teknik të kërkuar nga autoriteti kontraktor në DT.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik "SHPSF Snajper Security" sh.p.k qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Trezhnjeva" sh.p.k., për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", me nr. REF-43724-11-18-2019, me objekt, "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të godinave dhe ambienteve rrethuese të Spitalit Rajonal Diber", Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, tre vend roje me tre turne (T1+T2+T3)", me fond limit 9.487.854 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 02.03.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "SHPSF Snajper Security" sh.p.k.., në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Grand Security" sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorëve ekonomikë "Trezhnjeva" sh.p.k., "SHPSF Snajper Security" sh.p.k.., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i kualifikuar këta operatorë ekonomikë.
5. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë "Trezhnjeva" sh.p.k. dhe "SHPSF Snajper Security" sh.p.k.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 329 Protokolli**
**Datë 01.04.2020**

**Nr. 330Protokolli**
**Datë 02.04.2020**

**Nr. 335 Protokolli**
**Datë 06.04.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|---|
| Enkeleda Bega | Vilma Zhupaj | Lindita Skeja | Merita Zeqaj |

**Kryetar**
**Evis Shurdha**